

**CFARE PO NDODH
ME KRIPTOT?**

Bitcoin, poshtë 21 mijë dollarë për shumë kohë, Cila është e ardhmja e kriptovalutave

CASH IS THE KING

Paraja Kesh do vazhdojë të jetë Mbreti, nuk do të zhduket por do bëhet dixhitale

**START-UP NE
KOSOVE**

Zero financim nga qeverite dhe biznesi vendor

**INVESTIMET E
ULTA**

Investimet me te ulta ne rajon - Kosova

**PAGA GJERMANE NGA
KOSOVA**

20 mijë persona marrin rroga të Gjermanisë nga Prishtina dhe qytetet e tjera

**KOSOVA SUPERFUQI
SHANSI HUMBUR**

A e humbi Kosova shansin për tu shndërruar në një vend të pasur dhe superfuqi energjetike?

Magazine Qendra

PERMBAJTJA

03

**PARAJA KESH DO VAZHDOJË TË
JETË MBRETI, NUK DO TË ZHDUKET
POR DO BËHET DIXHITAL**

07

**STARTUP-ËT DHE TEKNOLOGJIA
INFORMATIVE, ZERO FINANCIM NGA
QEVERITË DHE BIZNESI VENDOR
INTERVISTE - URANIK BEGU**

09

**20 MIJË PERSONA MARRIN
RROGA TË GJERMANISË NGA
PRISHTINA DHE QYTETET E TJERA**



11

**A E HUMBI KOSOVA SHANSIN PËR TU
SHNDËRRUAR NË NJË VEND TË PASUR
DHE SUPERFUQI ENERGETIKE?**

15

**BITCOIN, POSHTË 21 MIJË DOLLARË
PËR SHUMË KOHË, CILA ËSHTË E
ARDHMJA E KRIPTOVALUTAVE
INTERVISTE - GRANIT KADOLLI**

20

**NVESTIMET ME TE ULTA NE
RAJON - KOSOVA**

START-UP

PARAJA KESH DO VAZHDOJË TË JETË MBRETI, NUK DO TË ZHDUKET POR DO BËHET DIXHITAL



Kompania amerikane "Vaiu Global" ka sjellë një inovacion të jashtëzakonshëm teknologjik për infrastrukturën dhe mënyrat e pagesave, të cilat pritet të fillojnë të aplikohen së shpejti. Paraja Kesh sic e njohim ne nuk do të zhduket, por do të transformohet në Kesh Digjital. Kjo mënyrë e pagesave e Keshit Digjital por edhe Bankomatëve digjital, një system ky i shpikur nga kompania amerikane Vaiu Global është vlerësuar si sulucion apo zgjidhja më intelegjente nga revista prestigjioze CIOReview. "Most Promising Mobile Payment Solution Provider" është vlerësimi për këtë inovacion.

Cash is king apo Paraja kesh është mbreti në gjuhën shqipe.

Kjo frazë shekullore mund edhe të zhduket, të mbetet një relike e së kaluarës, ndërsa shoqëritë tona marshojmë drejt një epoke të re me pagesa elektronike, digjitale, ndërsa kuletat tona do të jenë të mbushura me kartela të identitetit, patentshofër, kartela të ndryshme bankare, por pa para të letrës apo metalike.

Tendencat e fundit sugjerojnë se paraja dixhitale në një periudhë jo afatgjate, do të zëvendësojnë paratë fizike apo ato që quhen kartmonedha, monedha metalike, ndërkohë që qeveritë përvec se kanë reduktuar qarkullimin e parasë kesh, kanë vendosur kufizime të forta për në operacionet e pagresave.

Kjo lëvizje drejt një ekonomie pa para kesh në formë letre dhe metalike, ku shumica e pagesa kryehen me kartela bankare, pagesa elektronike apo dixhitale, vec aspketit pozitiv, ka dhënë edhe shqetësime te konsumatorët, për shkak të informatave personale që blerësi i jep sa herë që kryen një transakcion.

Ky shqetësim i konsumatorëve për informacionet personale është serioz dhe i drejtë, për shkak se të dhënat personale janë nën sulm të pamëshirshëm nga hakerat, krimi i organizuar, madje edhe grupe të sponsorizuara nga shtetet e ndryshme autokratike dhe diktatoriale, të interesuara për ti pasur këto të dhëna me cdo kusht.



Këto operacione përfshijnë mashtrimet e shumta, vjedhjen e identitetit dhe shantazh si formë e kërcënimit publik. Konsumatorët të cilët kanë shqetësime për privatësinë, të cilat shfaqen pas secilit transaksion pasi i siguron shitësit një pasqyrë të saktë për blerësin, nuk e kanë të njëjtin problem kur paguajnë me para kesh.

Transaksionet me para në dorë, janë anonime.

Por, çfarë mund të bëjnë institucionet financiare për të adresuar këto shqetësime të konsumatorëve, njëkohësisht me zvogëlimin e parasë kesh në qarkullim, formë e pagesës kjo që përdoret më së shumti nga sindikatat e krimit, financimi i terrorizmit dhe evazioni fiskal?

Zgjidhjen tani e ka kompania VAIU Global, e cila edhe në Kosovë ka bërë prezentimin e sistemit dhe shumë shpejt, bashkë me bankat dhe biznesin mund ta bëjnë një sistem të tillë të funksionojë në praktikë.

Me inovacionin e VAIU jo vetëm që do të ekzistojë paraja kesh në formë digjitale, por do të ketë edhe bankomate digjitale.

“Vaiu Global me inovacionin e saj do të ndihmojë bankat dhe bizneset të nisin një epokë të ngjashme me paratë kesh, përmes transaksioneve dixhitale, me inovacionin të cilin e zotërojmë dhe për të cilin jemi në pritje të patentës. Sistemi i jonë ofron karakteristikat pozitive të parave të gatshme duke reduktuar rreziqet e pagesës dixhitale për konsumatorët, sic është dhënia e të dhënave personale tek shitësi”, thotë Reza Jalili, Themeluesi i Vaiu Global, duke theksuar se gjithsesi vet banka i ka informacionet e plota për personin që shkëmben transaksione.

Saktësisht, Vaiu ofron një platformë të vetme, të konsoliduar për bankat, tregtarët komercialë dhe konsumatorët.

“Thelbi i ofertës tonë, është Vaiu Token Base, që është dixhital, por i ngjashëm me paratë e gatshme. Pothuajse kudo që ka një transaksion financiar, Vaiu mund të ndërhyjë, me më shumë avantazhe dhe kufizime më të vogla se paratë e gatshme. Vaiu ka krijuar një platformë teknologjike e cila do të integrojë bankat, tregtarin dhe qytetarin, duke përmbyllur ciklin e pagesave”, tregon Jalili.

Imagjinoni sikur një shok ju kërkon 20 euro borxh, por për ti marrë këto para atij do i duhet të vijë të ju takojë personalisht ose ju mund ti dërgoni atij këtë shumë përmes një transferte bankare, cila përveç se kushton merr edhe kohë, të cilën shumica e kanë të limituar.

Kështu ka qenë deri tash, por me platformën teknologjike të VAIU mjafton disa sekonda që ju ti dërgoni shokut shumën e kërkuar. Ajo mund ti dërgohet si shumë e deponuar nëse dy palët e kanë të instaluar VAIU apo në formën e një shifre- tokeni që është i barazvlefshëm me shumën.



Rrugët për tia transmetuar tokenin mikut tuaj janë të panumërta, dule filluar nga thirja telefonike, sms, messenger, whatsapp etj. Pra pagesa me VAIU mund të kryejë edhe personi që nuk ka llogari bankare, apo pa aplikacionin e VAIU-t, duke pasur vetëm tokenin që ka vlerën e shumës.

“Do të ketë një dinamizim të qarkullimit të Kesh-it dixhital, I cili nuk do të ketë nevojë për prezencë fizike të personave për tu shkëmbyer, që nuk gjuhën teknike quhet P2P (Person to Person)”, tha përfaqësuesi i VAIU për Kosovë, Rinor Ahmeti, për të shtuar se benificionet e përdorimit të keshit dixhital janë të panumërta.

“Lehtësimi i transaksioneve dixhitale që ne e quajme këtë Paraja përmes IP-së, sikur që është të folurit përmes IP, apo paketizimi i të folurit që ka reduktuar koston e telefonin për më shumë se 100 herë, paraja përmes IP është premtuese dhe do ta ulë koston dhe riskun, duke mundësuar transaksione më të shpejta në mes njerzve dhe në të ardhmen e afërt edhe në mes paisjeve dhe agjenteve softuerike, pavarisht distancës.

CLDT - Cash Like Digital Transactions, apo transaksionet dixhitale sikur kesh për ti mundësuar bankave komerciale implementimin në mënyrë sa më efikase, , prandaj për këtë qëllim Vaiu ka zhvilluar Vaiu Digital ATM.

Është shumë lehtë i integrueshem me aplikacionet ekzistuese të bankave, sikur Mbank, duke ofruar një ndërfaqe intuitive, të thjeshte, të castit dhe të sigurt që konsumatorëve të bankave ti mundësojë tërheqje, depozitim, transfer dhe shpenzim prej llogarise se tyre bankare.

Vaiu punon “seamless” me sistemet dhe proceset ekzistuese sikur KYC/AML ose ACH apo edhe transferat monetara SEPA - duke mbajtur ne anen tjetër koston e menaxhimit të ndryshimit të ultë për konsumatorët tonë” u shpreh Mark Hochberg - VP of Customer Success.

“Produkti jone Vaiu Digital ATM zvoglon varësinë e konsumatoreve në Bankomatet fizike dhe në infrastrukturën përcjellese të tyre, që praktikisht zvoglon kostot e operimit të bankës. Tregtarët komercial do të përfitojnë gjithashtu nga përdorimi i Transaksioneve digjitale sikur kesh - CLDT. Duke mos pasurë nevojë për mbledhjen, ruajtjen dhe përditesimin e të kredencialeve të konsumatorëve, kjo shpie në përvojë të shpejtë dhe më të thjeshtë të pagesave dhe përdorimi i kësaj metode zvoglon kohen dhe paret e shpenzuara në blerje mashtruese dhe rimbursime. Konsumatorët paguajnë në mënyrë dixhitale duke mos u brengosur për krimet kibernetike.

“Ne jemi të përkushtuar të ndihmojmë tregtarët dhe shitësit me pakicë të zvoglojnë mosmarrveshjet rreth transaksioneve të tyre me kredit kartelë për së paku 70 përqind” – thotë Rinor Ahmeti, përfaqësues. Dëshironi me teper? Konsumatorët mund ta përdorin Vaiu për t’iu qasur fondeve të tyre për të paguar faturat, abonimet dhe qirate në kohe reale.



Përmes aplikacionit Vaiu, konsumatorët tonë më nuk i ekspozojnë të dhënat e tyre të detajuara kur bëjnë pagesa jo-kesh (mendojeni transaksionet pa prezencën e kartës. Në vend të kësaj krijohet një token i financuar nga llogaria bankare apo karta e kreditit, token të cilin mund ta përdor edhe dikush që nuk ka llogari të veten.

Së fundmi një hotel i njohur ishte në kërkim të digjitalizimit të bakshisheve për punëtorët e tij, shërbim të cilin VAIU mund të ofrojë pa asnjë problem.

“Imagjoni jeni duke e lëshuar dhomën e hotelit, dhe deshironi të dhuroni bakshish mirembajtjes. Nxjerr kuletën dhe e sheh që keni vetëm banknota të mëdha, ose nuk keni fare kartmonedha. Shumica në këtë rast e lëshojnë hotelin pa lënë ndonjë bakshish”, tha Mark Hochberg

Sipas tij, Vaiu ka zhvilluar zgjidhjen më të mirë edhe për lënjen e bakshisheve në hotele.

“ Mysafiret e hotelit gjenerojnë kodin që përfaqëson vlerën që ata deshirojnë ta dhurojnë si bakshish njëjtte sikur që lënë bakshish me parë kesh. Transaksionet Vaiu në person janë edhe më të thjeshta. Mysafiret mund të përcjellin vlerën monetare përmes Chat, SMS email ose vetëm me prekje të telefonave”

VAIU ofron zgjidhje të ngjashme edhe për taksit, autobusa, dyqane ushqimore, restorane etj. Duke pasur parasysh dhe duke levizur drejt një të nesërme më të sigurt, Vaiu në mënyrë të vazhdueshme është duke përmirësuar dhe zgjeruar platformën e saj dhe në anën tjetër duke punuar me institucionet financiare lidere në Europë.

“Jemi në fazën e sigurimit të investimeve. Objektivi jonë kryesorë në 18-24 muajt e ardhshme përfshinë përshtetimin dhe zgjerimin e platformës sonë, rritjen e partneriteteve, stimulimin dhe adaptimin dhe kostumizimin e transaksioneve dixhitale - gjithkund, në çdo kohë dhe për secilin. Kjo është Vaiu” - Reza Jalili

“ Integrimi në rrjetin global të pagesave të menjëhershme të Vaiu™ është i lehtë me komponentin tonë të bankomatit dixhital në aplikacionin tuaj celular. Privatësia dhe komoditeti në çdo kohë, kudo akses në fonde duke ruajtur AML, KYC dhe duke qenë në pajtueshmërinë me GDPR ”

Vaiu për Tregtarët

Vaiu do të reduktojë kostot e transaksionive të bizneseve dhe tregtarëve deri në 70%. Duke përdorur platformën teknologjike Vaiu™, klientët do të mund të përdorin çdo formë pagese që dëshirojnë, ndërsa konfigurimi është i lehtë dhe kërkon vetëm pak minuta për t'u përfunduar.

Biznesi do të lirohet nga POS-ët e shumta të bankave, pasi mjafton vetëm shkarkimi i aplikacionit.

STARTUP-ËT DHE TEKNOLOGJIA INFORMATIVE, ZERO FINANCIM NGA QEVERITË DHE BIZNESI VENDOR

Qendra e Inovacionit të Kosovës, (ICK) u formua para 10 vitesh. Mbi 550 Startap dhe rreth 5 mijë vende të reja të punës janë krijuar nga kjo organizatë për 10 vite punë por qeveritë e Kosovës, pavarësisht se cila parti politike ka qeverisur vendin, nuk ka financuar asnjëherë këtë organizatë apo inovacionet e reja që kanë dalë nga të rinj e Kosovës. ICK mbetet vend i preferuar për fotografi nga politikanët, vizita gjatë fushatave elektorale dhe vend për propagandë, pasi mbështetja reale mungon.

“Startup-et dhe teknologjitë inovative janë e ardhmja e vendit. Kosova ka rinin të mirë edukuar në sektorin e IT, teknologjisë informative dhe ne do të bëjmë çdo gjë për të zhvilluar këtë sektorë. Ftojme kompanitë nga e gjithë bota për të investuar në Kosovë pasi mund të gjejnë resurse njerëzore në Teknologjinë Informative”.

Këto fjali në formë deklarata mund ti keni dëgjuar në televizione e vendit apo mund ti keni lexuar nëpër mediat e ndryshme elektronike dhe janë thënë pa përjashtim nga të gjitha qeveritë e Kosovës dhe partitë politike.

Të njëjtën qasje e kanë të shkruar edhe në programet e tyre dhe sa herë ka zgjedhje e shpалosin zëshëm në formë të premtimeve elektorale. Por këtu mbetet gjithçka.



Në realitet asnjë prej qeverive të Kosovës nuk ka ndihmuar financiarisht këtë sektorë, një e vërtetë që konfirmohet nga Uranik Begu, drejtor i Qendrës së Inovacionit të Kosovës, organizatë kjo qendrore në vend që mbështet të rinjtë dhe starapat që lindin nga iniciativat e tyre.

“ICK ka shënuar këtë vit 10 vjetorin e themelimit, dhe unë jam afërsisht që nga fillimi në pozitën e drejtorit ekzekutiv, ku roli dhe funksioni im lidhej dhe lidhet direkt me zhvillimin e organizatës dhe afirmimin e aktiviteteve të ICK në komunitet dhe më gjerë. Në fillimet e hershme ICK është mbështetur nga Ministria e Punëve të Jashtme të Norvegjisë kur dhe ka filluar aktivitetin me nismë të STIKK.

Kurse sot kryesisht ICK mbështetet nga SIDA dhe Ambasada Suedeze si përkrahësit kryesor të qendrës. Megjithatë ICK ndër vite ka krijuar dhe kultivuar raporte me gjithë organizatat që veprojnë në vend, duke u shndërruar në një platformë ku shume nisma të donatoreve janë gërshtuar për të rritur ndikimin në vend”, thotë Uranik Begu, drejtori Ekzekutiv i ICK, për qendra.info.

Sipas tij “fatkeqësisht, qeveritë e Kosovës gjatë këtyre viteve kanë qenë spektator në zhvillimin e ekosistemit të inovacionit dhe ndërmarrsis, kjo dhe shkak ndryshimit të shpeshtë të qeverisjeve ndër vite.

“ICK ka nevojë për një mbështetje të fortë institucionale në mënyrë që të zhvillojë dhe avancojë aktivitetet e veta, dhe rrjedhimisht të ndihmojë sa më shumë të rinj në fushën e inovacionit dhe ndërmarrësish”, thotë Begu.

Begu ka treguar se gjatë funksionimit vite ICK ka pasur mundësi që të realizojë shume projekte dhe nisma që me të vërtetë janë për mburrje dhe kanë pasur ndikim pozitiv në shoqëri.

“Do veçoja aktivitetet me karakter ndërkombëtar ku kemi lobuar që të integrojmë Kosovën e ekosistemin global. Po ashtu jemi krenar me nismat që kanë ndihmuar gratë dhe vajzat dhe gjithëpërfshirje e tyre në fushën e TIK, duke dhuruar mbi 600,000 euro bursa. Gjithashtu, pjesa e inkubatorit të ICK është një ndër të arriturat më të mëdha, ku kemi përkrahur mbi 550 startup me shërbime të ndryshme dhe grante, duke krijuar biznese të qëndrueshme dhe vende të reja punës (diku rreth 5000)”, thotë drejtori i ICK-se “, Uranik Begu, duke shtuar se edhe pse me shumë vështirësi dhe me mbështetje të vogël, shumë prej bizneseve nga komuniteti ynë sot shërbejnë në tregjet ndërkombëtare dhe janë pjesë e zhvillimeve teknologjike globale.

Ai sqaron se me pak më shumë investim financiar, shumë nga këto kompani do të ishin në gjendje edhe më të mire, duke pushtuar edhe më shume tregje me produktet dhe shërbimet e tyre. Mirëpo, jemi shume krenar dhe të lumtur me rritjen e shpejte dhe të qëndrueshme të shumë kompanive të reja në fushën e IT.

“Mbështetja institucionale ka munguar tërësisht në këtë drejtim, dhe fatkeqësisht ende nuk po shihet që institucionet kanë një vizion të qartë për të zhvilluar inovacionin dhe ndërmarrësin në vend.

Iniciativat private dhe ato publike, ende funksionojnë tërësisht në mënyrë paralele dhe pa ndonjë ndërveprim, dhe kjo nuk sjell dobi. Si ICK, deri tani nuk kemi pranuar asnjë mbështetje nga institucionet e vendit, edhe pse mbesim një vend i preferuar për vizita si për partitë politike edhe për delegacionet e jashtme”, shpjegon tutje drejtori ICK, Begu për qendra.info.

Puna e bërë në ICK për gjatë 10 ditëve ka kaluar nivelin lokal për përkrahjen dhe fuqizimin e bizneseve startup dhe po ashtu ka bërë mjaft edhe me promovimin e Kosove si një destinacion i ri dhe atraktiv për investim, sidomos në fushën e teknologjisë.

Puna e bërë në ICK për gjatë 10 ditëve ka kaluar nivelin lokal për përkrahjen dhe fuqizimin e bizneseve startup dhe po ashtu ka bërë mjaft edhe me promovimin e Kosove si një destinacion i ri dhe atraktiv për investim, sidomos në fushën e teknologjisë.

“Deri tani ne kemi organizuar me qindra vizita të investitorëve në Kosovë dhe anasjelltas ku bizneset startup kanë prezantuar të arriturat e tyre në tregjet e jashtme. Sigurisht, jo gjithçka varet vetëm nga ne, dhe vlerësoj që në radhë të parë puna profesionale, por edhe mbështetja institucionale për investitorët është tejet e rëndësishme.

Ne jemi një Organizatë me 15 punëtorë, një fondacion që mbështetet nga Ambasada Suedeze dhe SIDA. ICK e meriton që të gëzojë mbështetjen e munguar institucionale, dhe të ketë adresë të përhershme. Pa këtë mbështetje, funksionimi i ICK do të jetë ë vështirë në suaza të asaj që ofron sot. Andaj shpresoj që me një angazhim shtesë, edhe të energjive të reja nga vet ICK, por edhe një vizioni dhe angazhimi të ri qeverisës, ICK do të jetë në shërbim të inovacioneve edhe shume vite e dekada”, tha në fund të intervistë, Uranik Begu, kryeshef ekzekutiv i ICK.

20 MIJË PERSONA MARRIN RROGA TË GJERMANISË NGA PRISHTINA DHE QYTETET E TJERA



Numri i kompanive dhe i qytetarëve që punojnë në vend me rroga të Gjermanisë, në kompani që po ofrojnë shërbime të Teknologjisë Informative IT, Softuerike apo edhe Call Center ka ardhur duke i rritur vazhdimisht, për të shpërthyer pas pandemisë Covid 19, ku puna nga shtëpia u pranua nga shumë kompani. Janë mbi 20 mijë qytetarë në Kosovë që marrin “paga të Gjermanisë”, nga 1 mijë e deri në 6-7 mijë euro, varësisht nga shërbimet që ofrojnë për kompanitë e madha.

Bledar Krasniqi (emer i vendosur nga redaksia), qytetar nga Prishtina, me profesion programues, prej 6 muajsh merr një pagë prej mbi 5 mijë euro, ndërsa punon 8 orë në ditë nga apartamenti i tij në lagjen Dardania në Prishtinë. Këtë vend pune Bledari e kontrakttoi 6 muaj më parë drejtpërdrejt, pasi duke qenë i orientuar prej shumë vitesh në këtë profesion, njeh njerëz dhe kompani që rekrutojnë profesionistë që punojnë në këtë sektor. Kjo është puna e tretë të cilin ai e siguroi 6 muaj më parë nga Prishtina.

“ Kam qenë duke punuar në një kompani gjermane me një pagë prej 2.500 eurove. Duke qenë se kam kontakte me persona që janë brenda këtij tregut më erdhi propozimi për të kaluar me një kompani tjetër me një pagë dyfish më të madhe. Normalisht që do të pranoja. Punojë 8 orë në ditë dhe 5 ditë në javë”, thotë Bledari për qendra.info.

Për shkak të njohurive të mira dhe njohjes së shumicës së gjuhëve programuese, Bledari thotë se ka oferta për të punuar në të gjitha kompanitë në Kosovë që merren me “outsource”, numri i të cilave vazhdimisht ka ardhur duke u shtuar.

Llogaritet se qindra kompani të tillë operojnë në Kosovë dhe numri i tyre është shtuar veçmas pas pandemisë covid 19, ku puna prej shtëpisë u bë standard për shkak të mundësisë së infektimit.



“ Aktualisht kemi të punësuar rreth 450 persona me paga 800 euro për fillestarë dhe 2 mijë apo më shumë varësisht nga pozita. Por paga më të vogla nuk kemi. Punojmë për kompanitë e fuqishme financiare gjermane në fushën e IT-së, prodhimit të softëere-ëve, për shërbimet e energjisë elektrike, të transportit, etj, etj. Kemi mungesë serioze të kuadrove vendorë, tha për qendra.info, Hamdi Malushaj, CEO i kompanisë KiKxxl & EvroTarget L.L.C.

Sipas tij, në Kosovë edukimi i arsimor është shumë i mangët tek kuadrot e reja dhe nuk qëndrojnë të dhënat se Kosova është një treg me kuadro të aftë në sektorin e Teknologjive Informative dhe profesioneve tjera që po kërkohen në tregun e jashtëm.

“ Vijnë njerëz që kërkojnë punë dhe kanë të mbaruar fakultetin ekonomik dhe nuk dinë ti dallojnë konceptet me elementare. Është e tmerrshme. Sikur të kishim njerëz të arsimuar mund të them lirshëm që deri për Vitin e Ri pa asnjë problem do mund ti punësoja deri në 1 mijë punëtorë me pagat që përmendëm më lartë”, theksoi tutje Malushaj.

Edhe pronari i kompanisë Polymath Labs Muharrem Shefkiu tha për qendra.info se mundësit për të punuar në këtë sektor janë të mëdha, por si kompani jenë të kufizuar me numrin e njerëzve të arsimuar konkretisht.

“ Është një treg i vështirë për të gjetur persona adekuat dhe fillimisht duhet të trajtohen për përgatitje shtesë në pjesën më të madhe”, tha Muharrem Shefkiu, bashkëpronar në kompaninë.

Ai ka treguar se kompaninë e kanë themeluar bashkë me partnerin e tij dhe punojnë kontrata kryesisht me shtetet e huaja,

“ Kemi të punësuar mbi 20 persona me paga që sillen nga 700 për fillestarë e 1500 e më lart, varësisht nga pozicioni. Kompania punon me kontrata kryesisht nga tregu i jashtëm dhe për kompanitë e njohura. Jemi të kënaqur, gjithë planet janë të rritemi dhe të fuqizohemi në këtë sektor”, tha ai.



Kompanitë si kjo që udhëheq Muharremi Shefkiu nga Polymath Labs, duke qenë se punojnë në tregje të jashtme dhe atje realizojnë qarkullimin dhe fitimet, janë subjekte tatimore në shtetet ku kanë bazën.

“Në Kosovë ne paguhemi për shërbimet që kryejnë punëtorët tonë. Për të gjitha pagesat e tyre paguhen detyrime tatimore”, tha ai.



“

**Udhëheqës
ndërkombëtarë dhe
vendorë të Kosovës, pas
luftës së vitit 1999, kur
u vendosën nën siglën e
administratës
ndërkombëtare të
Kombeve të Bashkuara
në Kosovë, UNMIK, e
patën më se të qartë
emergjencën që kishte
Kosova.**

**Energjia Elektrike ishte
numri një i problemeve.**

Si një vend i shkatërruar nga lufta, përfshirë infrastrukturën jetike si energjia, ujësjellësi, telekomunikacioni, që në ditët e para të pasluftës, u përballë me mungesa të mëdha të energjisë elektrike.

Dy ishin arsytet që vendi nuk kishte energji në ditët e pasluftës, një rrjet energjetik i cili ishte dëmtuar gjatë luftës dhe nga mungesa e gjatë e investimeve të mirëmbajtjes, rrjeti energjetik duke përfshirë dhe termocentralet prodhuese, ishin vjetruar tashmë. Nuk dihej kur qenë bërë remont për herë të fundit.

A E HUMBI KOSOVA SHANSIN PËR TU SHNDËRRUAR NË NJË VEND TË PASUR DHE SUPERFUQI ENERGJETIKE?

Resursi kryesorë i Kosovës, thëngjilli, rezervat e të cilit vlerësohen të jenë mbi 40 miliardë tonë thëngjill, xehe e cila është kryesisht sipërfaqësore, shfrytëzohet minimalisht, duke qenë se Kosova prodhon pak energji, duke mos plotësuar as nevojat e veta. Energjia është kthyer në mallin më të kërkuar në të gjithë botën ndërsa çmimet e saj janë trefishuar, me një mesatare prej 200-300 euro për megavat orë energji elektrike. Dështimi për të ndërtuar një termocentral nga vitit 2003, për 20 vjet me radhë, bëhet më tragjik tani kur vendit i duhet të importojë energji me këto çmime të larta, gjithnjë derisa të ketë para.

Në kushtet e mungesës së energjisë si ndërkombëtarët ashtu dhe vendorët, kristalizuan qëndrimin që pa ndërtimin e kapaciteteve të reja energjetike, ndërkohë që ato ekzistueset hynin në remont dhe morën qindra miliona euro investime, Kosova nuk do të kishte stabilitet në furnizim me energji elektrike. Rrjedhimisht dhe pa energji elektrike nuk mund të flitej as për zhvillim ekonomik apo për tërheqjen e investimeve të huaja. Por pavarësisht se energjetika mori investimet më të mëdha nga donatorët e huaja për gjithfarë renovimesh në termocentralet Kosova A dhe Kosova B, gjeneratorët, kazanët, filtrat etj etj, lajmet kryesore nëpër mediat e shkruara dhe televizione në pesë vitet e para të pasluftës ishin orët e reduktimeve dhe rënia e blloqeve nga sistemi që u kthyen në problem sistematikë.



Projekti kryesohej nga ish ministri i atëhershëm Ethem Ceku dhe nëse do të realizohej, Kosova e Re do të kishte 2.100 megavat energji elektrike.

Por duke qenë të shpeshta dhe irrituese për qytetarët, rënja e shpeshtë e tyre linte arsyeja për thashetheme dhe fjalë për sabotime të qëllimshme. Dhe presione nga më të ndryshmet.

Puna vajti deri aty sa një nga kryeadministratorët e vendit që emronte UNMIK-u, i quajti termocentralet Dinosaurë, gjatë një vizite në këto termocentrale, të cilat pas një goditje rrufeje në një natë vere dolën komplet nga sistemi, duke cuar si prodhimin ashtu edhe furnizimin e qytetarëve në pikë kritike.

Si mund të ftosh një investitorë të vijë dhe ti rrezikojë paratë në një vend ku nuk plotësohet ku ka termocentrale të vjetër Dinosaur teknologjikë, kur puna elementare për ti futur makineritë në veprim apo një kompjuter të thjeshtë pa të cilin nuk kryhet puna, siç është energjia elektrike???

Nën këto episode të përditshme të pasluftës, qeveria e parë e vendit e cila i krijua pas vitit 2002, me emrin Institucionet e Përkohshme Qeverisëse të Kosovës, hartuan strategji dhe në vitin 2005 shpallën tender ndërkombëtarë për ndërtimin e Termocentralit Kosova e Re apo Kosova C, siç e quanin disa të tjerë për shkak të renditje alfabetike.

Projekti kryesohej nga ish ministri i atëhershëm Ethem Ceku dhe nëse do të realizohej, Kosova e Re do të kishte 2.100 megavat energji elektrike.

Garancia më e madhe e projektit gjigant prej 2.100 megavatesh, përveç qeverisë së vendit dhe institucioneve ndërkombëtarë, ishin rezervat e mëdha të thëngjillit, arsye kjo që solli kompanitë më të fuqishme botërore dhe evropiane në konkurrencë për ndërtimin e termocentralit.

Për ndërtimin e Kosova e Re prej 2.100 megavat kishte konkurruar dhe kompania gjigante gjermane RWE, çka e bënte projektin serioz si për konkurrencën ashtu dhe për vazhdimësinë e punës deri në dorëzimin e veprës strategjike prej 2.100 megavatesh.

Ata që e mendonin si punë të kryer projektin në këtë fazë, ju dukej e largët dita e përfundimit të Kosova e Re, e cila sipas projektit duhej të përfundonte në vitin 2012 apo 2013, 7-8 vite nga fillimi i punës së projektit.

Nga ai moment, jo 7-8 vjet, por po i afrohem gati një periudhe 20 vjeçare, viti i ri 2023 do vetëm dy muaj të vijë dhe Kosova nuk ka ndërtuar asnjë megavat. Vazhdojmë të furnizohemi me energji elektrike nga Dinozaurët e vjetër të cilët vazhdojnë të thithin miliona euro për remonte dhe riparime, por çka është me e keqja vazhdojnë të dalin nga sistemi dhe të bien, duke na lënë pa energji elektrike edhe pse kanë kaluar 20 vjet nga përfundimi i luftës.

Mungesa e energjisë së prodhuar në vend nuk u ndje nga viti 2010 e deri më tani, kur lufta në Ukrainë dhe bllokimi i eksporteve ruse të gazit, naftës dhe komponentëve tjerë për prodhimin e energjisë, u bë realitet dhe çoi çmimet e energjisë në stratosferë.

Nga fillimi i luftës në Ukrainë në muajin shkurt e deri më tani, çmimi mesatarë për një megaëat orë energji ka qenë nga 250 deri në 300 euro, çmim që detyroi Kosovën të harxhojë në muajt e parë të vitit mbi 120 milionë euro për import të energjisë elektrike.

Çmimi gjithashtu na kujtoi se sa të pambrojtur kemi mbetur dhe nën mëshirën e prodhimit nga termocentralet e vjetruar që mezi prodhojnë 800 megavat ndërsa konsumi i energjisë gjatë muajit të dimrit shkon deri në 1300 megavat, duke pasur minus 500 megavat të cilat do ti kemi të pamundura ti importojmë nëse çmimet nuk ulen por vazhdojnë të rriten.

Por si ndodhi që klasa politike dhe qeveritë në vazhdimësi, nuk bënë asgjë për ndërtimin e termocentralit të ri, por përkundrazi, tre herë filloi procesi me shpallje ndërkombëtare dhe të tre herët dështoi.

Askush nuk ka përgjigje zyrtare edhe pse për ndërtimin e termocentralit të ri ishin të gjitha kushtet.

Duke filluar nga thëngjilli e deri tek garancat ndërkombëtare për ndërtuesin dhe për financimin e tij.

Edhe atëherë kur planet ishin të ndëртоhej 2.100 megavat apo edhe kur u përgjysmua projekti dhe parashihej të ndëртоhej termocentrali prej 1.200 megavatesh.

Të kishte filluar të ndëртоhej gjithsesi. Me çfarëdo çmimi. Tani kur po shohim se çfarë po ndodhë dhe cilat janë pritjet për energjinë elektrike, pasja e satirave të tilla qoftë për konsum të brendshëm apo për eksport, do na kthente në vend të pasur, në superfuqi energjetike.

Me çmimet e tanishme, në variantin e termocentralit më të vogël, kuptohet po të ishte ndërtuar,

eksportet e energjisë elektrike do të tejkalonin shumën prej 2 miliard eurove, të cilat do të shkonin direk

në buxhetin e vendit dhe do të dyfishonin atë. Le pastaj që duke pasur energji të sigurt, do të na kthente

në një prej vendeve më atraktive për investitorët.

PO PSE NUK E BËMË ATË KUR I KISHIM MUNDËSIT?



Nga lobet serbe të energjisë që kanë monopole mbi transmisionet e deri tek interesat e tjera të huaja që nuk ishin të interesuara për ta parë Kosovën si fuqi energjetike në rajon dhe më gjerë ndikuan vendimmarrjen përmes presionit publik dhe medial, në emër të ndotjes apo elementeve të tjerë e ndonjëherë nga budallëku.

POR A JEMI VONË TANI?

Për ndërtimin e një prodhuesi të energjisë elektrike asnjëherë nuk është vonë. Kjo lloj energjie po bëhet gjithnjë më e nevojshme, duke pas parasysh që edhe automjetet të gjitha nga 2035 do jenë elektrike dhe nevojat për energji do shumëfishohen.

Krahas energjisë me thëngjill do të duhet të investojmë në energjinë me diell dhe format tjera alternative. Por asnjëherë të mbështetemi vetëm në një resor apo një formë. Ky dimër më shumë se gjithçka tjetër do na tregojë gabimet që kemi bërë. Na kanë kushtuar më shume seç mendojmë.





INTERVISTA: GRANIT KADOLLI, EKSPERT NE KRIPTOVALUTA

“

Popullata e Kosoves mendoj që është e kycun që nga viti 2014/2015 në tregun dhe investimet në kriptovaluta. Ndër vite tregu është zgjeruar për arsye të ngritjeve të mëdha dhe përfitimeve nga rritja në vazhdimësi që kanë pasur kriptovalutat.

Faktor kryesor për masivizimin e enamenti ka qene fakti që kemi një popullat të re në vend që ka njohuri solide në IT por nuk është vetëm ky faktorë.

BITCOIN, POSHTË 21 MIJË DOLLARË PËR SHUMË KOHË, CILA ËSHTË E ARDHMJA E KRIPTOVALUTAVE

Eksprtë të huaj dhe vendorë thonë se për momentin rritja e Bitcoin, Ethereum dhe kriptovalutave tjera, të cilat për 4-5 vite më radhë njohën vetëm rritje, Bitcoi shkoi në mbi 50 mijë euro, ka përfunduar për momentin. Sipas tyre 1 vit apo 2 do jenë vite të stagnimit për shkak të luftës në Ukrainë apo krizave tjera ekonomike botërore, për t'ia lënë radhën më pas një rritjeje të paprecedentë.



Kriptomonedha më e njohur në botë, Bitcoin, por edhe monedhat tjera pas saj si Ethereum etj, patën vitin më të keq gjatë 2020 pasi humbën vlerë të konsiderueshme, nga mbi 50 mijë euro që ishte vlera e një Bitcoinit në fillim të vitit, nën 20 mijë euro. Përveç Bitcoinit, rënje rapide pati edhe monedha tjetër më e njohur Ethereum, e cila nga 5 mijë euro për 1 Ethereum, tregtohet aktualisht në shumën prej rreth 1,500 eurove.

Monedha tjera patën fatin edhe më të keq, si Luna Coin, kriptomonedh e cila ishte shumë shpresëdhënëse, duke humbur të gjithë vlerën dhe për një moment cmimi i tyre në bursë ishte i barabartë me zero.

Por pavarësisht rënies dhe staginimit të kriptovalutave, ekspertë të huaj dhe vendor syrgjerojnë personave që kanë investuar në krypto që most ë ngutën për ti shitur por ti mbajnë sa më shumë që është e mundur pasi stagnimi është i përkohëshëm, 1 deri në 2 vite maksimi dhe më pastaj pritjet një rritje e paprecedentë.

Granit Kadolli, investitor në kriptovaluta por edhe analist i tyre në mediat e vendit, thotë saktësisht se fundi do të jetë i lumtur, por se duhet pritur.

Pas një rënje rapide që patën kriptomonedhat, nga 50 mijë euro për 1 bitcoin, duket që janë stabilizuar në një prag prej rreth 20 mijë eurove për bitcoin psh. Cilat janë parashikimet për të ardhmen e afërt?

Cdo krizë global apo edhe rastin e fundit që e kemi konfliktin Rusi/Ukrainë, ndikon tek investitorët në tregun kombëtar dhe ndërkombëtar. Edhe tek crypto valutat kjo situatë pati ndikim të madh pasi investitorët kryen shitje të mëdha të kriptovalutave nën efektin e panikut.

Ka shumë nga ata që janë të kyqun në tregtinë e kriptove që nga viti 2012/13 që bëjnë lëvizje me asetet e tyre digjitale prej crypto nëdollar amerikan apo euro dhe valuta tjera. Në këtë pikë ku është Bitcoin (po e marrim shembull sepse është i pari dhe ka kapitalin më të madh prej gjithë kriptovalutave tjera) sipas analistëve teknikë pretendohet që fundi i rënjes ka qenë jave më parë kur kishe cmimin 18.700 USD dhe analistët nuk po parashikojnë rënje të mëtejshme, edhe pse ka spekulime të ndryshme që do të bie deri në 16.000 mijë euro.

Gjithsesi pritjet më të mëdha nga njerzit kryesorë dhe analistët seriozë janë që do të ketë stagnim për shkak të krizës ekonomike mbarëbotërore, e cila do të çojë në falimentim 20 përqind të kompanive në të gjithë botën.

Bitcoin ka një të ardhme shumë të qëndrueshme dhe është një krypto valutë e cila ka shume indikatorë për cmimin dhe vlerën e ti që e mbanë.

Bitcoin ka një një PoW shumë të madhe (PoW e siguron rrjetin e BTC duke perfunduar transaksione të enkriptuara dhe duke siguruar rrjetin dhe tani për tani mendohet që ka fuqinë kompiuterike më të madhe se bote. Gjithashtu specifike e veçantë për BTC është edhe numri i limituar i sasisë së bitcoin dhe këto janë arsye kryesore që bitcoin mbanë këtë cmim.

Një tjetër fenomen që mendohet që është një nga indikatorët kryesorë është që sasi të mëdha të BTC kanë humbur (sipas statistikave diku 8 Milion BTC janë të humbura nga viti 2009) dmth I kanë harrur private key, passëord te ëallets etj.

Parashikimet sipas indikatorëve të ndryshëm janë që deri 2030 me arritë 500.000 USD për 1 BTC edhe pse kjo shume për mua personalisht më duket marramendese, mirpo mundet me ndodhë edhe një gjë e tillë deri në këtë vit. Unë personalisht parashikojë që një BTC diku në 2030 ndoshta do të arrijë 130/170 mijë euro duke marrë parasysh shumë indikatorë të tregut se cdo herë e më shumë në të ardhmen teknologjia po është prezente në jeten tonë dhe cdohere e me shume sistemi financiar bankarë po tenton me i automatizu transakcionet.

Çka do ju rekomandonit investitorëve nga Kosova si një prej ekspertëve më në zë i këtij sektori??

Unë personalisht shumë e shumë herë shumë shokë/miqe ju them që të investojnë aq sa kanë kapaicitet investues dhe me aq buxhet sa ata nuk do e lënënbkeq familjen e tyre. Jo me buxhet të kursimeve dhe të familjes së tyre.

Vite me pare kur Bitcoin ka qenë 3000 EUR dhe Ethereum ishte 100 EUR, ju kam sugjerur që të blejnë 1 BTC dhe 10 ETH edhe ti mbajnë ato për një kohë të gjatë ose tja dedikojnë fëmijeve te tyre. Në 2018 në një nga televizionet e Kosovës në një emision e kam cituar që nëse

investojnë 1 btc dhe 10 eth për fëmijët e tyre, pas 5/7 apo 8 viteve kur ai të rritet dhe bëhet për studime perveç që do tia pagujnë fakultetin më të mirë në botë po ndoshta edhe gjitha shpenzimet e tyre ndoshta edhe me shume.

Dhe 2021 BTC kishte cmimin 69.000 usd dhe ETH kishte 4.900 USD

Në lokalet në Prishtinë ku kryhet shkëmbimin e valutave të huaja dhe kriptomonedhave pohojnë që ka një rënie të aktivitetit për investime të reja dhe theksojnë se njerzit në Kosovë sikurse gjithë botën kanë pasur humbje të mëdha. A mund të dihet se sa mund të kenë investuar qytetarët e Kosovës në kriptomonedha??

Po është e vërtetë që shumë nga ata persona nuk I njohin tregjet ndërkombëtare edhe ndoshta nuk veprojnë sepse nuk kanë eksperience.

Tek ne në Kosovë ky fenomen nuk është prezent dhe munden me ndodhe nje gje e tille. Shume dhe shpesh here kur marr pyetje nga komuniteti unë ju kthej përgjigje me keto fjale:

“Kur bie tregu dhe I gjithë marketi është i gjakosun atëherë duhesh me ble sasi të madhe, ndërsa kur rritet tregu dhe fitimet tuaja janë rritur me dhjetë herë atëherë duhesh me shesësh një pjesë dhe të presësh deri tek rënia e ardhshme.

Asnjëher nuk mundemi me ditë kush sa ka investuar në Crypto Valuta përveq BQK nëse ka ndonjë raport që I filtron pagesat me credit card që jane bërë nga Bankat në Kosovë. Ka edhe nga ata që kanë investuar direkt nga minerat që ju shesin sasi të ndryshmentë crypto valutave klientëve etj.

Por definitivisht nuk mundemi të japim ndonjë shifër specifike për njerëzit se sa kanë humbur në kriptovaluta.

Si e shihni tregun në përgjithësi në Kosovë ku ende skemi ligj të kriptomonedhave dhe bankat janë hezituese dhe përveç në raste të ralla nuk pranojnë shkëmbime në kohë reale?

Popullata e Kosoves mendoj që është e kyqun që nga viti 2014/2015 në tregun dhe investimet në cryptovaluta. Ndër vite tregu është zgjeruar për arsye të ngritjeve të mëdha dhe përfitimeve nga rritja në vazhdimësi që kanë pasur kriptovalutat. Faktor kryesor për masivizimin e fenomenit ka qenë fakti që kemi një popullatë të re në vend që ka njohuri solide në IT por nuk është vetëm ky faktor. Çmimi i energjisë në Kosovë në raport me vendet e tjera ka qenë më i arsyeshëm dhe më konkurrues dhe kjo çoi në investime më prodhimin e kriptove.

Ky fenomen mu personalisht mënkë pëlqyer shumë sepse ju ka largu gazetat sportive nga dora rinis kosovare nëpër restorane & bare dhe tash i sheh duke marrë telefonin në dore dhe janë në përcjellje online të ecurisë.

Sa i përket ligjit në Kosovë nuk ma merr mendja që do të bëjnë dëkë të tillë sepse sot ende shtete të mëdha në botë nuk i kanë të rregulluara ligjet dhe perballen me këtë fenomen. Në këto kushte nuk pres që Kosova të ketë progres të shpejtë në këtë fushë. Me ligj është e rregulluar pagesa prej 10% e të ardhurave si pjesë e tatimit, por nuk ka ndonjë evidencë sa sa tatime mund të jenë paguar deri më tani nga ky aktivitet.


Si jeni ndarë personalisht me lëvizjet e pazakonshme të çmimit të kriptomonedhave.

Personalisht keni fituar apo qëndroni në pritje për tu rikthyer vlera e mëparshme??

Në biznesin e kriptomonedhave unë jam një holder që i bie investor në pritje, vitet 2016/2017 jemi ngut pak edhe nuk i kemi menduar shumë gjëra dhe nuk kemi vepruar mençur. Që nga viti 2018 e këtij veprimi më mençur dhe nuk ngutemi si të tentojmë të rrisim krypto asetet.

Ata që kanë hyrë më heret nuk ma merr mendja që janë humbës nëse i kanë sasinë të kriptomonedhave.

Mirpo ka shumë nga ata që janë ngutur dhe i kanë shitur para se me prek majen. Personalisht kemi vlerësuar se jemi të fituar nga dyfishimi dhe trefishimi i vlerës. Ka pasur raste që ka pasur ngritje 20 herë më shumë se vlera apo edhe 30 e deri në 3500 herë më shumë se vlera e blerë. Kanë fituar ata më të guximshmit që deri në fund nuk i kanë shitur kriptot e blera. Unë personalisht e shoh më ndryshe këtë teknologji, jo vetëm si para pavarësisht se jam në fitim, por jo shumë të madh. Për mendimin tim, kriptovalutat kanë një të ardhme shumë të mirë.



INVESTIMET NË KRIPTOMONEDHË, QYTETARËT HUMBJE MILIONËSHE DHE ZHYTJE NË BORXHE



Ethet e kriptove, të cilat dy-tre vitet e fundit përfshinë një pjesë të madhe të qytetarëve në Kosovën dhe shumicën e vendeve të botës, për momentin janë ndaluar pas humbjeve milionëshe nga ana e qytetarëve, një pjesë prej të cilëve kanë marrë edhe borxhe, rrjedhojë kjo e rënies së vlerës së kriptomonedhave si Bitcoin, Ethereum apo monedha të tjera, rënie kjo e parë pasi disa vjet këto kriptovaluta njohën vetëm rritje.

L. Beqiri nga Prishtina ju ka së paku 100 mijë euro borxh bankave dhe miqve të tij, para të cilat i huazoi për të investuar në kriptovaluta, një fenomen ky që pati përhapje masive vitin e kaluar dhe më herët.

Rritja e vazhdueshme e vlerës së tyre, qoftë përmes blerjes direkt apo prodhimit të tyre në vend, nuk la të ri dhe qytetarë në moshë të mesme pa folur, menduar apo për të investuar nëse patën para për të kryer një veprim të tillë, shpeshherë duke marrë edhe borxhe.

‘ Nga ky moment kur e kujtoj veprim tim për të blerë kriptovaluta, duke huazuar para normalisht që mendoj se ishte një gabim. Gjithsesi shpresa nuk ka humbur pasi kriptovalutat ende i posedoj dhe po presim që vlera e tyre t’iu rritet serish’, thotë Beqiri për qendra.info.

INVESTIMET ME TE ULTA NE RAJON - KOSOVA



Vendi ynë nuk ofron asnjë masë stimuluese për kompanitë që startojnë punë dhe punësojnë qytetarë për një vit e më shumë, pikë për të cilën në vendet në rajon ju japin nga 1 mijë euro për këtë punësim të qëndrueshëm.

Investimet e huaja më të ulëtat në rajon, të cilat Kosova i ka prej vitesh të tëra, reflektojnë mëradhë të parë konfuzitetin që kanë pasur të gjitha qeveritë e vendit për investimet e huaja.

Jashte procesit të privatizimit të ndërmarrjeve publike dhe shoqërore, një proces i cili filloi në vitin 2003 dhe ende nuk ka përfunduar, nuk ka pasur asnjë sektor që projektuesit dhe zbatuesit politikave ekonomike ta kenë fuqizuar për të shërbyer si joshësh për investitorët e hua

Ky fakt argumentohet me të dhënat që dëshmojnë se hiç faktin kur kemi pasur për të shitur ndërmarrje strategjike apo dhënë licensa të telefonisë mobile, ne asnjë moment tjetër nuk kemi tërhequr as edhe një investitorë serioz në vendin tonë. Investitorë nuk u arritë të tërhiqen edhe pse Kosova ka përmisuar në mënyrë të jashtëzakonshme infrastrukturën rrugore, aeroportuale, ka krijuar qasje të lehtë me portet kryesore në rajon apo edhe pse përmisoi në mënyrë të dukshme pozitën në raportet e Bankës Botërore dhe organizmave tjerë për lehtësinë e të bërit biznes në vend.

INVESTIMET ME TE ULTA NE RAJON - KOSOVA

Vendi ynë nuk ofron asnjë masë stimuluese për kompanitë që startojnë punë dhe punësojnë qytetarë për një vit e më shumë, pikë për të cilën në vendet në rajon ju japin nga 1 mijë euro për këtë punësim të qëndrueshëm.

Janë diskutuar në opinion shumë herë për investimet e huaja apo investorët kredibil që poinvestojnë në vendet fqinje, ndërsa faktit që ata kanë anashkaluar Kosovën i është lënë fajin politikanëve dhe korrupsionit në vend. Pa mohur ekzistencën e këtij fenomeni, korrupsioni prek vendin tonë në të njejtën masë sikurse vendet fqinje, për të cilat duket që nuk po është pengesë. Ndaj, më shumë se ky fenomen, mungesa e investimeve të huaja në radhe të parë lidhet me politikbërsit e vendit që nuk kanë definuar se në cilin sektor mund të jemi konkurent krahasuar me fqinjët, me qëllim fokusimin aty dhe krijimin e kushteve sa më të mira për ti tërhequr në vendin tonë.

Kur flitet për tërheqjen e investimeve të huaja, si në mendjen e politikanëve ashtu edhe të qytetarëve ende janë xehet, minierat apo dhe ëndërrat për të tërhequr prodhues automobilash në vendin tonë, duke harruar faktin se Kosova për momentin nuk ka resurse njerëzore që do ta bënte atraktiv për një gjë të tillë. Mungesa e krahut të kualifikuar të punës jo për investorët e huaj, por është problem edhe për qindra kompani vendase të cilat paketojnë, prodhojnë produkte të industrisë së lehte, ushqimore apo veshjeve në vend.

Ndaj dhe para se të flasim për investime të huaja, ti identifikojmë sektorët se ku mund të jemikonkurrues. Me dhjetëra universitete që vazhdojnë të prodhojnë mijëra juristë ekonomistë, duke anashkaluar shkollat profesionale, do qëndërojmë në vend pa bërë ndonjë lëvizje përpara. Shkollimin profesional dhe vlerat që përfaqëson për botën aktuale, e dëshmon dhe sektori i IT, sektori i zhvillimit (programerët), dizajnit, i cili jo vetëm është ngritur kohëve të fundit pa asnjëndihmë të qeverisë, por po jep shembuj të suksesshëm. Veçmas, nga momenti i pandemisë, kur puna nga distanca zuri vend kryesorë në gjithë botëndhe vendin tonë.



QENDRA
BUSINESS MAGAZINE.

Nr.01 - 03 Nentor 2022